



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 3 dt. 10.03.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, si dhe nenit 116, 117 të Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 10.03.2014, pasi shqyrtoi Vendimet e marra nga KKR për “Restaurimin, rigjallërimin dhe rivlerësimin e Kalasë së periudhës mesjetare Lezhë”, të diskutuara në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Shpalljen absolutisht të pavlefshëm të aktit administrativ Vendim i KKR nr. 15 dt. 10.05.2013 “Për miratimin e afatit të qerases për projektin “Rijetëzimi i Kalasë Mesjetare të Lezhës”.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike, për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI